

**Procedura e aplikimit për një dokument arkivor gjyqësor  
nga një subjekt kërkues [individ dhe person fizik/juridik]**

Në mbështetje të VKM Nr. 252, datë 29.04.2022, “Për procedurat e ofrimit të Shërbimeve *ON-LINE* nga institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”, **shërbimi i dërgimit dhe/apo studimit të çfarëdo dokumenti arkivor gjyqësor kryhet vetëm nëpërmjet platformës e-albania.**

**ASNJË KËRKESË NUK PRANOHEM ME POSTË APO PERSONALISHT PRANË NESH.**

Hapni linkun [www.e-albania.al](http://www.e-albania.al), përdorni butoni Hyr, më pas zgjidhni opsionin si qytetar, vendosni numrin personal të ID dhe fjalëkalimin për të aksesuar profilin tuaj.

**Klikoni tek Shërbime me titullin: “Aplikim online për dokumente arkivore gjyqësore nga Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor”.**

➤ **Klikoni opsionin Përdor**

**Zgjidhni llojin e aplikimit:** Zgjidhni opsionin - Njohje pronësie/trashëgimie; Birësim, Njohje atësie; Penale;

**Lidhja e kërkuesit me paditësin:** Zgjidhni opsionin - Vetë personi; I ati/e ëma; Gjyshe; Katragjyshe; Trashëgimtar tjetër;

**Të dhënat e dosjes gjyqësore - Plotësoni vendet bosh:**

Numri i vendimit..... Data, muaji, viti ..... Gjykata.....

**KUJDES:** Nëse nuk keni lidhje të qartë me dokumentin gjyqësor që kërkoni, **DUHET** të bashkëlidhni dokumentin që vërteton lidhjen ligjore.

si trashëgimtar - **Certifikatë trangu familjar dhe Certifikatë vdekje e paraardhësit;** ose

si përfaqësues ligjor – **Prokurë të Posaçme;** ose

në rast të fitimit të pronësisë me blerje - **Kontratë shitje-blerje** me subjektin palë në procesin gjyqësor, dokumentacionin e të cilit kërkoni të aksesoni; ose

në rast regjistrimi prone të paluajtshme – **Shkresë nga ASHK vendore** që përcakton nevojën e aksesit të dosjes gjyqësore të një pale tjetër;

➤ **Klikoni opsionin Dërgo.**

Pas marrjes së kërkesës online, pas verifikimit përkatës për dokumentin dhe lidhjen ligjore, nëse dokumenti arkivor gjyqësor i kërkuar ndodhet në ASHSGJ në aplikimin tuaj në platformën e-albania ngarkohet fatura e pagesës.

Kërkuesi shkarkon faturën dhe kryen pagesën në çdo bankë. [Tarifa e shërbimit është 1500 leke plus 200 lekë x çdo akt nga dosja gjyqësore nëse i takon dhe ekziston pranë nesh].

**Pasi kërkuesi ngarkon konfirmimin bankar për kryerjen e pagesës në aplikimin e kryer, ASHSGJ i vë në dispozicion kërkuesit dokumentin arkivor gjyqësor të kërkuar në format digjital me nënshkrim elektronik brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune.**

**NËSE** nga verifikimi i kryer: a. dokumenti arkivor gjyqësor i kërkuar **NUK** rezulton në fond; apo b. dokumenti që vërteton lidhjen ligjore me të **NUK** bashkëlidhet në aplikim; **ASHSGJ** saktëson në shkresën e ngarkuar në aplikim arsyen e mosngarkimit të aktit/dokumentit gjyqësor të kërkuar.

**NËSE** konfirmimi bankar për kryerjen e pagesës **NUK** bashkëlidhet në aplikim, **ASHSGJ REFUZON OFRIMIN E SHËRBIMIT** duke saktësuar në shkresën e ngarkuar në aplikim arsyen.



**DREJTORI**

**Dr. Alfred Çausi**